



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute*

**RAPORTI VJETOR I INSTITUTIT  
GJYQËSOR TË KOSOVËS  
(IGJK)  
2008**

## Tabela e përmbajtjes

|  |    |
|--|----|
| 1. Hyrje .....   | 1  |
| 2. Struktura organizative e IGJK-së .....  | 1  |
| 2.1. Këshilli Drejtues .....   | 1  |
| 2.2. Këshilli Programor.....   | 2  |
| 3. Programet Trajnuese të IGJK-së.....   | 2  |
| 3.1 Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL).....  | 2  |
| 3.1.1 Programi dhe kalendari trajnues.....   | 2  |
| 3.1.2 trajnimet e PVAL.....  | 3  |
| 3.1.3 Trajnimet nga fusha penale.....  | 3  |
| 3.1.4 Trajnimet nga fusha civile.....  | 5  |
| 3.1.5 Trajnimet nga KEDNJ.....   | 5  |
| 3.1.6 Trajnimet nga lëmia e kundërvajtjes.....   | 6  |
| 3.1.7 Trajnimet për gjyqtarë porotë.....   | 7  |
| 3.1.8 Trajnimet nga fusha e etikës.....  | 7  |
| 3.2. Funksionet e reja të IGJK-së.....   | 7  |
| 3.2.1 Provimi përgatitor/Hyrës.....  | 8  |
| 3.2.2 Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL).....  | 9  |
| 3.2.2.a Modulet, Kalendari trajnues dhe ekspertët.....   | 10 |
| 3.2.2.b Trajnimi i Trajnuesve për hartimin e moduleve për fazën e parë dhe të ytë.....   | 10 |
| 3.2.2.c Organizimi, hartimi dhe zbatimi i provimeve në kuadër të PFAL .....  | 11 |
| 3.3 Trajnimi i trajnuesve.....   | 12 |
| 3.4 Aktivitetet tjera trajnuese.....   | 12 |
| 3.4.1 Tryezat e diskutimit për Kodin Penal të Kosovës .....  | 12 |
| 3.4.2 Aftësitë menagjuese për kryetar dhe administrator të gjykatave.....  | 13 |
| 3.4.3 Hartimi i Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor për vitin 2009.....  | 13 |
| 3.4.4 Zbatimi i Ligjit kundërt Diskriminimit.....  | 13 |
| 4. Integrimi ndërkombëtar.....   | 13 |
| 4.1 Vizita Studimore e këshillit të Programit në Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri.....  | 13 |
| 4.2. Vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe në Shkollën Kombëtare të<br>Magjistraturës në Francë.....   | 13 |
| 4.3. Pjesëmarrja në Rrjetin e Lisbonës dhe Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor.....   | 14 |
| 5. Transparenca .....  | 14 |
| 6. Aktivitetet tjera të realizuara nga IGJK.....   | 14 |
| 6.1. Trajnimi i stafit e IGJK-së.....  | 14 |
| 6.2. Takimet me Donator.....   | 14 |
| 7. Aktivitetet e realizuara me donator.....  | 14 |
| 7.1 Aktivitetet e realizuara me USAID/NCSC.....  | 14 |
| 7.2 Aktivitetet realizuara me UNDP.....  | 15 |
| 7.3 Trajnimet të cilat janë bashkëorganizuar me Këshillin e Evropës.....   | 15 |
| 7.4 Aktivitetet e realizuara me US-DOJ.....  | 15 |
| 7.5 Aktivitetet e realizuara me USAID/Bearing Point.....   | 16 |
| 7.6 Aktivitetet e realizuara me UNICEF.....  | 16 |
| 7.7 Aktivitetet e realizuara me AER- B&S.....  | 16 |
| 7.8 Aktivitetet e realizuara me Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR)<br>mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë..... | 16 |
| 7.9 Mbështetja nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) –<br>Misioni në Kosovë.....  | 16 |

---

|  |    |
|--|----|
| 8. Financa/Buxheti i Institutit Gjyqësor të Kosovës.....   | 17 |
| 9. Përfundim .....   | 17 |
| 10. Aprovimi i Raportit.....                               | 18 |
| 11. Aneksi I – Kalendar i aktiviteteve për vitin 2008..... | 19 |

## 1. Hyrje

Ky raport vjetor ka për qëllim që të paraqesë punën dhe të arriturat e Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) në ushtrimin e funksioneve ligjore të tij, në vitin 2008.

Ligji nr. 02/ L-25 mbi “Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës” i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më datën 23 shkurt 2006 i shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, përmes Rregullores nr. 2006/ 23 themelon Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) si institucion të pavarur, përgjegjës për të ofruar aftësim profesional për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës si dhe për të përgatitur profesionalisht kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm.

Sipas këtij ligji IGJK-ja gjatë punës së vet zhvillon plane aftësimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efikase, efektive dhe të paanshme dhe kryen edhe veprimtari të tjera profesionale për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Duke iu përgjigjur nevojave të sistemit gjyqësor dhe me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor, Instituti Gjyqësor i Kosovës gjatë vitit 2008 përveç Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor, ka filluar realizimin edhe të programeve të tjera trajnuese të cilat dalin si përgjegjësi nga ligji, aktet nënligjore dhe Plani Strategjik i IGJK-së.

Në fund të muajit qershor dhe fillim të korrikut u hartua, vlerësua dhe administrua Provimi Përgatitor/Hyrës për kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë, ndërsa në shtator të këtij viti u fillua realizimi i programit për përgatitjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë i ashtuquajtur Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL).

## 2. Struktura organizative e IGJK-së

Organet drejtuese të IGJK-së janë; Këshilli Drejtues dhe Drejtori i IGJK-së. Këshilli Drejtues përbëhet prej 13 anëtarëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës pas propozimit nga institucionet përkatëse të cilat i përcakton ligji, ndërsa Drejtori është zgjedhur nga Këshilli Drejtues.

IGJK-ja gjatë vitit 2008 kishte 17 të punësuar, ndërsa për vitin 2009 do të ketë edhe 4 pozita shtesë.

### 2.1. Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues i IGJK-së, gjatë vitit 2008 ka mbajtur disa takime të rregullta në të cilat ka marrë disa vendime dhe ka miratuar disa dokumente të rëndësishme, si më poshtë:

- Statutin e IGJK-së,
- Planin Strategjik tre vjeçar,
- Kornizën e Aktiviteteve për Organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor,
- Formimin e Këshillit Programor si organ konsultativ i Këshillit Drejtues,
- Formimin e Komisionit për Hartim dhe Vlerësim të Provimit Përgatitor/Hyrës,
- Miratimin e Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor, për vitin 2009,
- Miratimin e projekt buxhetit të IGJK-së, për vitin 2009,

- Zgjedhjen e nënkryetarit të Këshillit Drejtues të IGJK-së.

## 2.2. Këshilli Programor

Këshilli Programor i IGJK-së, si organ konsultativ, përbërja, funksionet dhe përgjegjësitë e të cilit janë paraparë me Statutin e IGJK-së, në takime e veta të rregullta ka diskutuar dhe miratuar disa dokumente me rëndësi për realizimin e programeve trajnuese, ndër të cilat:

- Dokumentin mbi Kronologjinë e Veprimeve për Organizmin e Provimit Përgatitor. Sipas këtij dokumenti i cili bazën e ka në Ligjin për Themelimin e IGJK-së, kandidatët për postin e gjyqtarit apo prokurorit zgjedhën në bazë të konkurrimit publik dhe të hapur përmes të cilit ata i nënshtrohen provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë. Pas këtij provimit 30 kandidatët më të suksesshëm do t'i nënshtrohen Programit Fillestar për Arsimim Ligjor.
- Strukturën dhe përbërjen e moduleve trajnuese për fazën e parë dhe të dytë të PFAL.
- Draft programin e trajnimeve për Programin e Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor.

Gjatë vitit 2008, Këshilli Programor i IGJK-së realizoj edhe disa takime dhe mori disa vendime të rëndësishme të cilat e ndihmuan zhvillimin efikas të funksioneve të IGJK-së.

## 3. Programet trajnuese të IGJK-së

### 3.1 Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL) është një nga aktivitetet më të rëndësishme të IGJK-së. Ky program ka për qëllim që të zhvilloj aftësitë dhe shkathtësitë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë duke i ushtruar funksionet e tyre. Brenda vitit 2008 PVAL-in ka përmbajtur një numër të madh të trajnimeve nga fusha të ndryshme të së drejtës dhe praktika gjyqësore.

#### 3.1.1 Programi dhe kalendari trajnues<sup>1</sup>

Për hartimin e Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor të vitit 2008 është përdorur një metodologji e veçantë, e cila është mbështetur në:

- vlerësimin e nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilat janë shprehur përmes pyetësorëve për vlerësimin e nevojave, të cilët iu janë dërguar të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës,
- takimet me trajnuesit e IGJK-së, të të gjitha fushave të drejtësisë,
- analizën e të gjithë pyetësorëve vlerësues të shpërndarë gjatë sesioneve trajnuese,
- diskutimet me ekspertët e angazhuar gjatë dhe pas sesioneve trajnuese,
- diskutimet me gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe prokurorët e shtetit të Kosovës,
- rekomandimet e bëra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
- rekomandimet e bëra nga OSBE (LSMS).

---

<sup>1</sup> Kalendari i trajnimeve të realizuara i është bashkëngjitur këtij raporti.

Temat të cilat janë trajtuar gjatë këtij viti janë përgjigje e kërkesave të drejtpërdrejta të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të nxjerra nga vlerësimet e nevojave të tyre dhe shprehje e nevojave për trajnime të cilat kanë dalë nga domosdoshmëria e problemeve të shfaqura në praktikën gjyqësore.

### **3.1.2 Trajnimet e PVAL**

Të gjitha aktivitetet trajnuese të organizuara gjatë vitit 2008 në këtë program trajnues kanë qenë të planifikuara në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme për vitin 2008, i cili ishte miratuar nga Këshilli Drejtues i IGJK-së në dhjetor të vitit 2007.

Numri i përgjithshëm i trajnimeve në kuadër të Programit të Vazhdueshëm të Trajnimeve në vitin 2008 ka qenë 96 (nëntëdhjetë e gjashtë). Po ashtu gjatë vitit 2008 IGJK-ja ka realizuar edhe 25 tryeza pune ku është diskutuar e tërë përmbajtja e Kodit Penal të Kosovës. Nga këto tryeza kanë dalë rekomandime konkrete për ndryshimin dhe plotësimin e këtij kodi. Këto rekomandime i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë për procedim të mëtejshëm.

Nëpërmjet këtyre trajnimeve IGJK-ja në bashkëpunim me ekspertë dhe trajnues vendorë dhe ndërkombëtarë ka synuar trajtimin dispozitave dhe çështjeve ligjore të paqarta për gjyqtarët dhe prokurorët, diskutimin e legjislacionit të ri vendor, legjislacionin Evropian, konventat dhe praktikën e ndryshme me qëllim të ngritjes së standardeve, avancimit profesional të gjyqësorit dhe përafrimit të tij me atë ndërkombëtarë.


Përfitues të trajnimeve në Programin e Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor janë: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve, gjyqtarët porotë dhe bashkëpunëtorët profesional në gjykata dhe prokurori. Ndërsa në disa trajnime specifike, si përfitues kanë qenë edhe specialist të fushave të tjera të ndërlidhura ngushtë në sistemin e drejtësisë, si: avokat, policë, zyrtarë nga shërbimi doganor, zyrtarë të shërbimit sprovues dhe zyrtar të qendrave për punë sociale.

### **3.1.3 Trajnimet nga fusha penale**

Brenda vitit 2008, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka realizuar 44 trajnime nga fusha penale.


Temat të cilat janë trajtuar gjatë këtyre trajnimeve kryesisht kishin të bëjnë me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale, Ligjin Penal për të Mitur, Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, çështjet e krimit financiar dhe korrupsionit, trafikimit me njerëz dhe çështjet e kundër diskriminimit.

Qëllimi i temave të trajtuara nga Kodi i Përkohshëm Penal ka qenë; sqarimi dhe kuptimi më i drejtë i elementeve të veprave penale, vështrimi analitik i dispozitave penale, interpretimi i tyre si dhe ngritja e nivelit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim të zbatimit të drejtë në praktikë.



Temat të cilat janë trajtuar nga Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale ka qenë të larmishme dhe kryesisht kanë dominuar temat nga procedura paraprake. Risitë të cilat parashihen në këtë pjesë të Procedurës Penale dhe kërkesat e mëdha të pjesëmarrësve kanë bërë që këto tema të trajtohen me prioritet.

Qëllimi i temave të trajtuara në këtë pjesë ishte që pjesëmarrësve tu sqarohet; kuptimi, autorizimi dhe roli i organeve kompetente në procedurë, aplikimi i masave në parandalimin e krimit, planifikimi dhe teknikat e hetimit në luftimin e krimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë kur viktimat janë fëmijë, unifikimin e praktikës gjyqësore etj.



Në kuadër të programit trajnues, IGJK vazhdimisht i ka kushtuar rëndësi Ligjit Penal për të Mitur. Qëllimi i temave të trajtuara ishte ndihma për gjyqtarët dhe prokurorët për të mitur që të trajtojnë rastet e të miturve në përputhje me dispozitat e aplikueshme dhe standardet ndërkombëtare.

Një vëmendje e caktuar i është kushtuar edhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, më qëllim të ngritjes dhe forcimit të profesionalizmit të të gjithë atyre të cilët janë të përfshirë në këtë fazë të procedurës, për ti vënë në jetë vendimet gjyqësore penale.


### 3.1.4 Trajnimet nga fusha civile

Gjatë vitit 2008 Instituti Gjyqësor ka organizuar 25 trajnime nga lëmia civile.

Në fokus të trajnimeve nga kjo lëmi ishin temat nga e drejta reale-sendore, procedura kontestimore, procedura jashtë kontestimore dhe përmbartimore. Po ashtu janë trajtuar tema edhe nga fushat si: e drejta familjare, e drejta trashëgimore, e drejta ekonomike dhe e drejta administrative.

Qëllimi i trajtimit të këtyre temave ka qenë ofrimi i njohurive më të avancuara lidhur me legjislacionin ekzistues, sqarimi i dilemave lidhur me çështjet më problematike të praktikës, prezantimin e praktikave më të mira. E gjithë kjo është bërë për evitimin e të metave dhe ngritjen e shkathtësive praktike në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjeve për zgjidhjen e drejtë të rasteve praktike.

Në fushat të cilat ka pasur risi, si; e drejta ekonomike, administrative etj, qëllimi i temave të trajtuara ka qenë, interpretimi dhe sqarimi i dispozitave të reja ligjore, ndikimi i tyre në praktikë si dhe thellimi i njohurive të gjyqtarëve të cilët vendosin për rastet civile lidhur me zgjidhjet ligjore që ofrojnë këto risi.




### 3.1.5 Trajnimet nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ)

Në këtë vit IGJK-ja ka organizuar trajnim lidhur me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDNJ) në katër regjione të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë dhe në regjionin e Mitrovicës.



Bazuar në kërkesat dhe nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, temat që janë trajtuar në këto trajnime kanë qenë të ndërlidhura me nenin 5 dhe 6 të KEDNJ-së.


Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë; ofrimi i njohurive më të avancuara lidhur me arsyet e privimit nga liria, kohëzgjatja e këtij privimi, prezumimi i pafajësisë, të drejtat e të pandehurit, procesi i rregullt gjyqësor dhe koha e arsyeshme për gjykim. Këto çështje janë trajtuar në frymën e interpretimit të Konventës nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vlerësimit të respektimit të këtyre të drejtave nga praktika gjyqësore e vendit tonë.



### 3.1.6 Trajnimet nga lëmia e kundërvajtjeve

IGJK në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor ofron trajnime edhe për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje.

Brenda këtij viti janë mbajtur pesë tryeza pune, ku janë trajtuar: Ligji i ri për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, veprat kundërvajtëse dhe përgjegjësia për kundërvajtje si dhe procedura kundërvajtëse ndaj të miturve.



<sup>2</sup> Pjesëmarrja etnike ishte e zvogëluar për shkak të rrethanave të krijuara në shoqërinë kosovare.

### 3.1.7 Trajnimet për gjyqtarë porotë

Një nga funksionet të cilat IGJK-ja është e obliguar ta realizoj sipas ligjit, është edhe organizimi i kurseve për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë. Këto trajnime kryesisht janë organizuar nëpër të gjitha regjionet e vendit (Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë).

Temat të cilat janë trajtuar gjatë këtyre kurseve janë fokusuar në rolin e gjyqtarëve porotë në procedurën penale, procedurën civile, në procedurën penale për të mitur si dhe respektimin e Kodit të Etikës për gjyqtarët porotë.


Qëllimi i këtyre kurseve trajnuese ka qenë; ngritja e nivelit dhe kapaciteteve vendimmarrëse të gjyqtarëve porotë, ndërsa me theks të veçantë është trajtuar roli i tyre me rastin e vendosjes së rasteve praktike në praktikën gjyqësore.

### 3.1.8 Trajnimet nga fusha e etikës

Në vitin 2008 IGJK ka vazhduar t'i kushtojë rëndësi trajnimeve nga fusha e etikës gjyqësore. Kryesisht trajnimet nga kjo fushë janë organizuar nëpër regjione dhe kjo praktikë do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Një nga objektivat kryesore të këtyre trajnimeve është ngritja e vetëdijes së gjyqtarëve dhe prokurorëve për respektimin e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale, me qëllim që veprimet dhe sjelljet e tyre të jenë në përputhje me standardet më të larta nga kjo fushë.

Në këtë vit janë realizuar gjashtë trajnime lidhur me Kodin e Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë, të nivelit bazik dhe të avancuar.



### 3.2 Funksionet e reja të IGJK-së

Pas përgatitjeve të shumta paraprake, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në vitin 2008 ka filluar implementimin e njërit nga programet më premtuese për mbështetjen e sistemit gjyqësor të Kosovës, Programin për Përgatitjen e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të ardhshëm.

Përgatitjet për të filluar realizimin ky program i cili ndryshe emërtohet si Programi Fillestar për Arsimim Ligjor, janë zhvilluar me kronologjinë e përshkruar si më poshtë:

### 3.2.1 Provimi Përgatitor/Hyrës


Ligji mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Nr. 02-L/25 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në nenin 2.1 (a) dhe (b) dhe 7, përcakton se IGJK-ja është institucioni kryesor përgjegjës për aftësimin bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë), dhe obligon IGJK-në që të bëjë vlerësimin dhe organizimin e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë.

Më 2 qershor 2008, Këshilli Drejtues i IGJK-së me qëllim të fillimit të punës rreth realizimit konkret të Provimit Përgatitor, miratoi përbërjen e Komisionit për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës.

Në javën e parë të qershorit 2008 në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës është publikuar shpallja publike me të cilën ftohen për aplikim kandidatët e interesuar.

Nga data 12 deri më datë 30 qershor, kandidatët kanë pasur mundësi që të regjistrohen për t'iu nënshtruar Provimit Përgatitor/Hyrës. Gjatë kësaj kohe janë regjistruar 172 kandidatë, prej tyre 108 kanë qenë meshkuj, 64 femra, 170 shqiptarë, një nga komuniteti turk dhe një nga komuniteti goran. 113 prej tyre kanë preferuar profilin për gjyqtar, ndërsa 59 profilin për prokuror.

Në mbështetje të UNDP-së me datën 20 dhe 21 qershor është mbajtur tryeza e punës gjatë të cilës është hartuar Provimi Përgatitor/Hyrës<sup>3</sup>.



Me datën 10 dhe 14 korrik 2008, është organizuar Provimi Përgatitor/Hyrës për kandidatët e regjistruar për t'iu nënshtruar këtij provimi<sup>4</sup>.

<sup>3</sup> Lidhur me hartimin, mbajtjen dhe vlerësimin e provimit përgatitor/hyrës është përgatitur dhe publikuar raport i veçantë.

Me datën 28 korrik 2008, Instituti Gjyqësor i Kosovës, publikoi rezultatet e provimit si dhe Raportin për Organizimin, Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor.

Me datën 11 shtator është organizuar një takim orientues me kandidatët me rezultatet më të larta. Në këtë takim kandidatëve iu dhanë informata të detajuara për datën e fillimit të trajnimit, kohëzgjatjen, orarin si dhe për modalitetet tjera të cilat janë konsideruar të arsyeshme. Po ashtu në këtë takim është nënshkruar marrëveshja në mes IGJK-së dhe kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë me të cilën rregullohen marrëdhëniet në mes kandidatëve dhe IGJK-së lidhur me programin trajnues.

### 3.2.2 Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

Bazuar në Ligjin për Themelimin e IGJK-së, Statutin, Kornizën e Aktiviteteve për Organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor si dhe praktikat e vendeve të rajonit e më gjerë, kandidatët për bartjen e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit nuk mund t'i ushtrojnë këto funksione pa kaluar nëpër sistemin e trajnimeve të veçanta të parapara me Programin Fillestar për Arsimim Ligjor.

Ky program trajnimi, sipas ligjit, organizohet dhe administrohet nga IGJK dhe iu dedikohet kandidatëve potencial për postin e gjyqtarit dhe prokurorit të cilët e kanë kaluar Provimin Përgatitor/Hyrës.

PFAL zhvillohet në periudhën prej 15 muajve dhe është i ndarë në tri faza. Secila fazë përfshinë disa module trajnimi ku përmbledhet pjesa teorike dhe praktike e mësimit.

Faza e parë dhe e dytë përmbajnë trajnim nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, ligjet Evropiane, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare. Faza e parë zgjatë gjatë (6) muaj dhe kandidatët mbajnë trajnimet në një grup.



<sup>4</sup> Raporti mbi Organizimin, Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor për kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë, Instituti Gjyqësor i Kosovës, 28 korrik 2008,

Faza e dytë zgjatë tre (3) muaj ku kandidatet janë të ndarë në dy grupe dhe ndjekin trajnime të specializuara.

Në fazën e tretë, kandidatët do të marrin pjesë në një program të udhëhequr nga mentorët e caktuar nga IGJK-ja dhe do të realizohet në gjykata dhe prokurori, (neni 8 i Ligjit Nr. 02/L-25).

Qëllimi i këtij programi është përgatitja sa më e mirë profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm në mënyrë që ata të jenë specialistët më të përgatitur dhe të trajnuar në nivelin më të lartë.

Me datën 18 shtator 2008 në një ceremoni solemne të organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës u shënua fillimi i Programit Fillestar për Arsimim Ligjor. Kjo ceremoni u nderua edhe nga, Presidenti i Republikës së Kosovës Z. Fatmir Sejdiu si dhe personalitete të tjera shtetërore të Republikës së Kosovës, udhëheqës të institucioneve gjyqësore, përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtarë në Kosovë që mbështesin sistemin gjyqësor dhe përfaqësues nga institucionet regjionale të trajnimit gjyqësor.

### **3.2.2.a Modulet kalendari trajnues dhe ekspertët**

Pas një pune gjithëpërfshirëse dhe në konsultim të vazhdueshëm me Këshillin Programor është arritur që të përcaktohen modulet të cilat do të prezantohen në trajnimin fillestar si dhe kalendari i trajnimeve në kuadër të këtij programi.

Ky program trajnues përmban 34 module trajnuese të cilat do të prezantohen në një periudhë prej 9 muajve të ndarë në dy faza.

Për realizimin e këtyre moduleve është angazhuar një numër i caktuar i trajnuesve vendor dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë hartuar dhe janë duke zbatuar modulet trajnuese sipas modeleve më bashkëkohore që përdorin institucionet ndërkombëtare të trajnimit që aplikojnë trajnimin fillestar.

Këto module u janë shpërndarë kandidatëve në momentin e fillimit të trajnimit fillestar.

Orari i trajnimeve është përcaktuar të jetë 3 ditë të plota pune në një javë, ku në secilën ditë në fazën e parë do të trajtohen nga 4 module.

Për përgatitjen e formës, përmbajtjes dhe publikimin e këtyre moduleve, Instituti u mbështet nga UNDP-ja dhe USAID/BearingPoint.

### **3.2.2.b Trajnimi i trajnuesve për hartimin e moduleve për fazën e parë dhe të dytë të PFAL**

Më datën 17 dhe 18 korrik 2008, u mbajt trajnimi i trajnuesve për hartimin e moduleve trajnuese për fazën e parë të PFAL. Pas këtij trajnimi i cili u tregua mjaft produktiv, trajnuesit e angazhuar në fazën e parë arritën të punojnë të gjitha kurset trajnuese të cilat u përmblodhën në module të veçanta të formatit i cili sot përdoret në institucionet trajnuese më të avancuara në Evropë.

Një trajnim i ngjashëm u realizua më 05 dhjetor të vitit 2008 për grupin e dytë të trajnuesve të cilët do të angazhohen në fazën e dytë të PFAL e cila pritet të fillojë në fillim të muajit mars të vitit 2009.

Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte që trajnuesit të cilët janë angazhuar në trajnimet e PFAL-it, të aplikojnë metodologjinë dhe format më bashkëkohore të hartimit dhe realizimit të moduleve trajnuese.



### 3.2.2.c Organizimi hartimi dhe zbatimi i provimeve në kuadër të PFAL

Me qëllim të matjes së aftësive dhe shkathtësive të fituara nga kandidatët që ndjekin trajnimet e PFAL, IGJK ka administruar provimin e mes fazës së parë për të gjithë kandidatët.

Ky provim është hartuar nga trajnuesit më datën 24 nëntor 2008, ndërsa është administruar nga IGJK më datat 15, 17 dhe 19 dhjetor 2008. Rregullat për organizimin dhe administrimin e këtij provimi kanë qenë të njëjta me rregullat e zbatuara në Provimin Përgatitor/Hyrës<sup>5</sup>.

Standardet e aplikuara gjatë hartimit, organizimit, administrimit dhe vlerësimit të këtij provimi janë më të lartat të njohura dhe të njëjta me ato që aplikojnë institucionet ndërkombëtare të trajnimit në Evropë dhe më gjerë. Provime të tilla do të organizohen në përfundim të çdo faze të PFAL dhe rezultatet e kandidatëve do t'u dërgohen autoriteteve përgjegjëse për rekomandimin final të tyre për emërim.

<sup>5</sup> Shih Raportin për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor.



### 3.3 Trajnimi i trajnuesve

Aplikimi i metodologjive moderne gjatë prezantimeve të trajnuesve dhe ekspertëve, në kuadër të aktiviteteve trajnuese të IGJK-së, ka qenë dhe mbetet një sfidë e cila kërkon një investim të vazhdueshëm.

Në këtë drejtim trajnimi i trajnuesve është një nga aktivitetet e veçanta që Instituti Gjyqësor i Kosovës i ka kushtuar rëndësi të posaçme edhe gjatë vitit 2008. Brenda këtij viti Instituti, në bashkëpunim me NCSC të përkrahur nga USAID-i ka mbajtur një kurs bazik dhe një kurs të avancuar trajnimi si dhe një trajnim për trajnues të Kodit të Etikes. Përfitues të këtyre trajnimeve kanë qenë trajnuesit e përhershëm dhe të përkohshëm të IGJK-së.

Qëllimi i këtyre trajnimeve është që trajnuesve tu ofrohen njohuri në përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, përgatitjen e moduleve trajnuese, përgatitjen e sesionit trajnues, përcaktimin e objektivave të trajnimit, formësimin e përmbajtjes dhe detyrave të trajnimit dhe përcaktimin e metodave për prezantim të suksesshëm.

### 3.4 Aktivitetet tjera trajnuese

#### 3.4.1 Tryezat e diskutimit për Kodin Penal të Kosovës

IGJK gjatë vitit 2008, rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe diskutimeve në nivel të ekspertëve të Kodit Penal të Kosovës. Me këtë rast janë mbajtur 25 tryeza pune në të cilat janë trajtuar dispozitat të cilat janë paraqitur si problematike apo të paqarta për praktikën gjyqësore.

Gjatë këtyre tryezave janë vënë në pah zbrazëtitë ligjore, dilemat dhe disharmonia e dispozitave ligjore të Kodit Penal të Kosovës. Përfundimet të cilat janë arritur në këto tryeza, në formë të rekomandimeve për ndryshime, i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë për procedim zyrtar me qëllim të ndihmës së procesit për plotësimet dhe ndryshimet e Kodit Penal të Kosovës.

### **3.4.2 Aftësitë menaxhuese për kryetarë dhe administratorë të gjykatave**

Më datat 21, 22, 23 dhe 27, 28 dhe 29 tetor 2008, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me NCSC-në të mbështetur nga USAID-i, ka organizuar dy seminare tri ditore, me temë “Aftësitë menaxhuese për gjyqtarë dhe administratorë të gjykatave”. Qëllimi i këtyre seminareve ishte që të identifikohen dhe diskutohen përgjegjësitë e punës së kryetarit dhe administratorit të gjykatës, zhvillimi i objektivave dhe puna ekipore, rishikimi dhe përmirësimi i objektivave si dhe praktikat më të mira në administrimin e gjykatave. Përfitues të këtyre trajnimeve ishin kryetarët dhe administratorët e gjykatave.

### **3.4.3 Hartimi i Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor për vitin 2009**

Instituti Gjyqësor i Kosovës i mbështetur nga UNDP-ja, më datën 8 dhe 9 nëntor 2008 ka mbajtur tryezën e punës me temë ”Hartimi i Programit të Vazhdueshëm të Trajnimeve të IGJK-së, për vitin 2009”. Qëllimi i kësaj tryeze ishte që të bëjnë vlerësimin e programit të vitit 2008, shqyrtimi i nevojave të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për vitin 2009, propozimet konkrete për programin e vazhdueshëm të IGJK-së për vitin 2009 dhe trajtimin e metodave bashkëkohore që do të aplikohen në trajnime për vitin 2009 në cilësi të pjesëmarrësve të kësaj tryeze pune ishin trajnuesit e përkohshëm dhe stafi i programit të IGJK-së.

### **3.4.4 Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit**

Më datë 18 nëntor Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Qendrën Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Budapest, (QEDNJR), organizoi seminarin njëditor lidhur me zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Në këtë seminar u trajtuan çështjet që kanë të bëjnë me; të drejtën e UE-së dhe traktatet tjera ndërkombëtare kundër diskriminimit, obligimet tjera ndërkombëtare lidhur me diskriminimin përfshirë këtu (KEDNJ) dhe (QEDNJR), pasqyrën e përgjithshme dhe implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë.

## **4. Integrimi ndërkombëtarë**

### **4.1 Vizita studimore e Këshillit të Programit në Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri**

Me datën 25 dhe 26 shtator 2008, anëtarët e Këshillit Programor të IGJK-së, përfshirë kryetarin e Këshillit Drejtues, realizuan një vizitë dyditëshe në Republikën e Shqipërisë. Kjo vizitë u përqendrua kryesisht në Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë me qëllim të njohjes dhe këmbimit të përvojave në mes institucioneve përkatëse të dy vendeve në fushën e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë me fokus të veçantë në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor.

### **4.2 Vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës së Francës**

Me datë 12 deri me 14 nëntor 2008, në mbështetje të Këshillit të Evropës, Këshilli Drejtues dhe Drejtori i IGJK-së realizuan një vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës së Francës. Gjatë vizitës këtyre dy institucioneve u dha mundësia për të parë nga afër zhvillimi, funksionimi dhe praktikat më të reja sistemit francez



të drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës. Kjo vizitë u konsiderua shumë përfituese dhe model për zhvillimin e mëtejshëm të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

### **4.3. Pjesëmarrja në Rrjetin e Lisbonës dhe Rrjetin Evropiane të Trajnimit Gjyqësor**

Gjatë vitit 2008, në cilësi të vëzhguesit, IGJK, mori pjesë aktive në të gjitha takimet e organizuara nga Rrjeti i Lisbonës dhe Rrjeti Evropiane i Trajnimit Gjyqësor.

## **5. Transparenca**

IGJK ofron informacione të rregullta lidhur me aktivitetet e realizuara, përmes web faqes e cila ka këtë adresë [www.kjjudicial.org](http://www.kjjudicial.org). Ky web site është publikuar me 22 shtator 2008, është funksional dhe i rifreskuar në baza të rregullta.

Gjithashtu, gjatë vitit 2008 IGJK, ka vazhduar me publikimin e aktiviteteve të tij. Njëra nga këto forma është Buletini i IGJK-së, përmes të cilit publikohen të gjitha aktivitetet që realizohen në periudha të caktuara kohore dhe pasqyrohet një përmbajtje e shkurtër e aktiviteteve trajnuese dhe veprimtari të ndryshme të Institutit.

## **6. Aktivitetet tjera të realizuara nga IGJK**

### **6.1. Trajnim për stafin e IGJK-së**

Me datë 21-23 nëntor 2008, në mbështetje nga UNDP, u realizua një trajnim për stafin IGJK-së lidhur me zhvillimin dhe sfidat e Institutit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e shkathtësive profesionale për kryerjen e përgjegjësive të punës dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit në frymën e punës ekipore. Puna në grupe dhe luajtja e roleve u përdorën si metoda për të shprehur rolin e secilit anëtarë të stafit në IGJK.

### **6.2 Takimet me donator**

Gjatë vitit 2008 IGJK, çdo tre muaj, ka organizuar takime të rregullta koordinuese me donatorët dhe partnerët të cilët kanë mbështetur dhe po e mbështesin IGJK-në në realizimin e aktiviteteve të ndryshme trajnuese. Në këto takime morën pjesë; përfaqësues nga: USAID-i/NCSC, UNDP, Këshilli i Evropës, UNICEF, Komisioni Evropian, OSBE, ABA/ROL -i, UNMIK-u, Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve, Qendra Juridike e Kosovës, Bearing-Point/USAID, Oda e Avokatëve të Kosovës, Zyra Gjermane, Banka Botërore etj. Qëllimi i këtyre takimeve ishte koordinimi i aktiviteteve të donatorëve në raport të mbështetjes së IGJK-së për nevojat e mundshme.

## **7. Aktivitetet e realizuara me donatorë**

Realizimi i një numri të madh të aktiviteteve në të gjitha programet trajnuese të IGJK-së nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe ndihmën financiare të donatorëve të cilët veprojnë në Kosovë dhe me të cilët IGJK ka një bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Gjatë vitit 2008 IGJK kishte një mbështetje dhe bashkëpunim me të gjithë donatorët.

### **7.1 Aktivitetet e realizuara me USAID/NCSC**

USAID/NCSC, kryesisht ka mbështetur IGJK-në në realizimin e aktiviteteve trajnuese në Programin e Vazhdueshëm dhe në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor, si organizimin e:

- Trajnimeve bazike dhe të avancuara mbi Kodin e Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë,
- Trajnimin e Trajnuesve, të nivelit bazik dhe të avancuar,
- Trajnimin e grupit të trajnuesve të Kodit të Etikës
- Trajnimet mbi Aftësitë Menagjuese për kryetarët dhe administratorët e gjykatave.

Po ashtu nga USAID/NCSC është ofruar një mbështetje lidhur me hartimin dhe prezantimin e moduleve të caktuara të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor, si:

- "Shkrimi arsyetimi dhe hulumtimi ligjor",
- "E drejta kushtetuese dhe Administrative".

## **7.2 Aktivitetet e realizuara me UNDP**

Gjatë vitit 2008 UNDP-ja ka mbështetur dhe financuar aktivitete të ndryshme të IGJK-së, në kuadër të Programit të Vazhdueshëm, Programit Fillestar për Arsimim Ligjor dhe nga fusha e publikimeve. Ndër këto aktivitete, veçojmë:

- Hartimi dhe publikimi i Planit Strategjik,
- Tryeza për hartimin e Provimit Përgatitor/Hyrës,
- Hartimi i modulit "KEDNJ-Legjislacioni për të drejtat e njeriut" (një ekspert vendor),
- Publikimi i të gjitha moduleve dhe materialeve ligjore për kandidatët e Programit Fillestar për Arsimim Ligjor,

Po ashtu UNDP, ka mbështetur Programin Fillestar për Arsimim Ligjor edhe në drejtime tjera, duke paguar një shumë të hollash si burse për kandidatët e këtij programi dhe një ushqim ditor të tyre.

Ndërsa në kuadër të Programit të Vazhdueshëm të trajnimeve, UNDP ka mbështetur trajnimet lidhur me:

- Hartimin e aktakuzës, (disa trajnime regjionale),
- Mbrojtjen kundër dhunës në familje,
- Procedurën civile sipas mjeteve juridike,
- Tryezën për Hartimin e Draft Programit për Arsimim të Vazhdueshëm të Arsimim Ligjor.

UNDP ka mbështetur edhe një trajnim të stafit të IGJK-së.

## **7.3 Trajnimet te cilat janë bashkë organizuar me Këshillin e Evropës**

Ngjashëm sikur viteve të mëparshme edhe gjatë vitit 2008, Këshilli i Evropës ka mbështetur realizimin e trajnimeve mbi Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (4 trajnime, 2 ditore), në të cilat janë trajtuar kryesisht nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së si dhe praktika e Gjykatës së Strasburgut.

## **7.4 Aktivitetet e realizuara me US-DOJ**

Instituti Gjyqësor në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të SHBA-ve (US-DOJ), ka realizuar:

- trajnime lidhur me marrjen e vendimeve në rastet e trafikimit me njerëz dhe veprave penale të ngjashme dhe
- trajnime lidhur me paraburgimin.

### **7.5 Aktivitetet e realizuara me USAID/Bearing Point**

USAID/Bearing-Point ka mbështetur IGJK-në në realizimin e trajnimeve nga e Drejta Tregtare dhe atë në temat specifike si:

- Ligji mbi Markat Tregtare
- E drejta Ekonomike – Arbitrazhi,
- Ligji mbi Ndërmarrjet.

Po ashtu USAID/Bearing-Point, ka mbështetur trajnimin e trajnuesve lidhur me metodologjinë e hartimit të moduleve të përdorura në PFAL.

### **7.6 Aktivitetet e realizuara me UNICEF-in**

Edhe UNICEF-i, gjatë vitit 2008 ka vazhduar mbështetjen e IGJK-së në organizimin e trajnimeve lidhur me Ligjin Penal për të Mitur, me ç'rast gjatë vitit 2008 janë organizuar disa trajnime regjionale, ku në fokus të trajtimit ishte aplikimi i masave dhe dënimeve për të mitur, veçanërisht aplikimin e masave të diversitetit.

### **7.7 Aktivitetet e realizuara me AER- B&S**

Agjensioni Evropian për Rindërtim (Komisioni Evropian) në implementim nga B&S, gjatë vitit 2008 kanë ndihmuar në organizimin e sesioneve të veçanta trajnuese lidhur me hetimin e krimit financiar (12 ditë trajnimi), pastrimin e parave dhe gjurmimin e pasurive (10 ditë trajnimi).

### **7.8 Aktivitetet e realizuara Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR) mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë**

Ky asociacion ka mbështetur IGJK-në në organizimin e një sesiioni trajnues lidhur me zbatimin e ligjit kundër diskriminimit, në të cilin në cilësi të trajnuesve kanë marrë pjesë trajnues ndërkombëtarë.

### **7.9 Mbështetja nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)– Misioni në Kosovë**


Realizimi i funksioneve të Institutit Gjyqësor të Kosovës, sidomos implementimi i programeve të reja trajnuese, gjatë vitit 2008 u mbështet edhe nga OSBE, misioni në Kosovë. Kjo mbështetje kryesisht është realizuar përmes këshilltarit special që OSBE ka ofruar për IGJK-në. Këshilltari special i OSBE-së ofroj këshilla në bazë ditore, ndihmoj në ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese dhe administrative të IGJK-së. Po ashtu këshilltari special i OSBE-së ndihmoj në zhvillimin e planprogrameve trajnuese në kuadër të programit të vazhdueshëm dhe atij fillestar për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

## 8. Financat/Buxheti i Institutit Gjyqësor të Kosovës

Instituti Gjyqësor i Kosovës financohet vetëm nga Buxheti i Kosovës, ndërsa mbështetje ka gjetur edhe nga donator të cilët ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve trajnuese në kuadër të PVAL-it, PFAL-it dhe nga fusha e publikimeve.

Viti 2008 IGJK-në e gjeti përball sfidave të shumta financiare. Me rregulloren 2008/13 (Ligji nr. 03/L-013) aprovohet buxheti për të gjitha institucionet qeveritare përfshirë edhe IGJK-në.

Tabela në vijim pasqyron raportin e ekzekutimit të buxhetit të IGJK-së nëpër kategori ekonomike.



Nga totali i aprovuar dhe i shpenzuar i buxhetit të IGJK-së, pjesa më e madhe e mjeteve i takojnë kategorisë ekonomike Mallra dhe Shërbime. Mallrat dhe Shërbimet janë kategoria kryesore që reflekton fondet për të gjitha aktivitetet dhe programet e IGJK-së.

## 9. Përfundim

Instituti Gjyqësor i Kosovës ka përmbyllur me sukses vitin 2008 në përputhje me programin vjetor të trajnimeve, Planin Strategjik, vendimet e Këshillit Drejtues dhe dokumenteve të tjera vepruese.

Ky vit shënoj një rritje të aktiviteteve trajnuese që u zhvilluan në kuadër të funksioneve të IGJK-së. Më poshtë po paraqesim një përmbledhje të shkurtër të të arriturave:

- Funksionimi efikas i organeve drejtuese, sidomos Këshillit Drejtues të IGJK-së,
- Funksionimi efikas i Këshillit Programor,
- Rritja e numrit të trajnimeve dhe llojllojshmëria e tyre në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL),

- Organizimi dhe vlerësimi i Provimit Përgatitor/Hyrës për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë,
- Fillimi i realizimit të Programit për përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhëm të Kosovës (PFAL),
- Organizimi i trajnimeve të veçanta për trajnuesit e IGJK-së,
- Publikimi i web faqes së IGJK-së,
- Hartimi i Programit të Vazhdueshëm të trajnimeve për vitin 2009 në mbështetje të nevojave reale të gjyqtarëve dhe prokurorëve,
- Organizimi i vizitave studimore dhe trajnimeve për organet udhëheqëse dhe stafin e IGJK-së,
- Zhvillimi i raporteve të mira me donatorë të shumtë dhe pranimi i mbështetjes së tyre mbi bazë të nevojave të IGJK-së,

Viti 2008 shënoj fillimin e një kapitulli të ri në Kosovë dhe në historinë e IGJK-së. Më e veçanta ishte fillimi i programit për përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm (shkolla e magistraturës). Në vitin 2008 me ndihmën e Qeverisë së Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtarë, IGJK-ja arriti të hyjë në botën e edukimit kualitativ duke arritur ose tejkaluar të gjitha standardet ndërkombëtare lidhur me trajnimin e kandidatëve të ri për gjyqtarë dhe prokurorë. IGJK-ja po ashtu filloj të aplikojë metodologjitë moderne lidhur me trajnuesit.

IGJK është i vetëdijshëm se viti 2009 do të jetë sfidues sikurse viti 2008. Procesi i zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, padyshim se do të krijojë pengesa dhe mundësi. Por, nëse historia shërben si mësim dhe vazhdon mbështetja nga Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, IGJK-ja mund dhe do t'i tejkalojë këto sfida.

## 10. Aprovimi i Raportit

Duke u bazuar në nenin 8.3.d. të Statutit të IGJK-së, ky raport vjetor u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të IGJK-së prezent në mbledhjen e datës 13 mars 2009.

Kryetari i Këshillit Drejtues:  
*Prof. Dr. Vesel Latifi*

**11. Aneks I.**

Kalendari i trajnimeve/aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2008.

| Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor   | Muajt |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
|---|-------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|
|   | I     | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |
| Aktiviteti i realizuar  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Ligji mbi trashëgiminë  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Prokurori publik  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Eksproprijimi   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale                           |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Ligji për Familjen i Kosovës  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Hetimet   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Kontratrat  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Provat në procedurën penale   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Kodi i Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Marrja e vendimeve në rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Veprave penale të ngjashme |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut Regjioni i Prishtinës (dy ditor)       |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Procedura kontestimore – Paditë   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Paraburgimi   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Procedura përmbarimore  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Ligji Penal për të Mitur (masat e diversitetit dhe masat edukuese)                            |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Marrja e vendimeve në rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Veprave penale të ngjashme |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Seminar për gjyqtarët porotë  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Simulim – penale  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Mënyrat e fitimit të pronësisë  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Simulim – civile  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut – Regjioni i Prizrenit (dy ditor)      |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| E drejta e punës  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Paraburgimi   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Paraburgimi ( Regjioni i Mitrovicës)  |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Gjyqtarët për kundërvajtje (veprat dhe përgjegjësia për kundërvajtje)                         |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |
| Shqyrtimi gjyqësor – penale   |       |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |







